


DETAJ

KONTAKT

MARGA





KONTAKT

A Rr Jordan Misja AI - 1057 Tiranë
C +355684049444 **E** info@kontakt.al
W kontakt.al

Kontakt u themelua në vitin 1999 në Tiranë.

Forma Legale e Kompanisë:
Shoqëri me Përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k)
NIPT/TIN: J921080006V
Kodi Fiskal: 3708169

Falë eksperiencës së gjatë në ndërtimet civile dhe rolit drejtues në treg, KONTAKT synon të jetë çdo herë zgjedhja e parë e klientit.



AVANTAZHET E CILËSISË KONTAKT

Konstruksion 10-ballë
Termoizolim
Zhurmëizolim
Hidroizolimi
Antizjarr

KONSTRUKSIONI

- 6 Sigurim Teknik
- 8 Vinç
- 10 Gërmim
- 12 Pilota
- 14 Levozhgë
- 16 Hekur
- 18 Beton
- 20 Skela
- 22 Nënshtrësë
- 24 Izolim Akustik Horizontal
- 26 Muraturë
- 28 Suvatim

FASADA

- 32 Fasadë e Ventiluar
- 34 Dritare
- 36 Vetratë Dyqane
- 38 Grilë
- 40 Parapet Xhami

TEKNIKA E SHTËPISË

HIDROIZOLIME

- 44 Hidroizolim Nëntokë
- 46 Hidroizolim Tuatele
- 48 Hidroizolim Llozha
- 50 Hidroizolim Tarraca 0.00
- 52 Hidroizolim Tarraca
- 54 Baxhë
- 56 Hidroizolim Gropa Ashensorit
- 58 Davancal Dritare
- 60 Davancale në Tarracë

MEKANIKE

- 62 Ashensor
- 64 Shkallë
- 66 Derë Teknike
- 68 Derë e Blinduar
- 70 Derë e Brëndshme
- 72 Kuti Poste
- 74 Sinjalistikë Rrugore
- 76 Tabelizim
- 78 Pllaka
- 80 Laminat

ELEKTRIKE

- 82 Transformatori
- 84 Matësa Elektrik
- 86 Çelsa, Priza
- 88 Ndriçues Brenda
- 90 Ndriçues Jashtë
- 92 Telefon, Tv, Internet
- 94 Rrufepritës

HIDRAULIKE

- 96 Uji Furnizim
- 98 Pompë Uji
- 100 Matësa
- 102 MKZ
- 104 Shkarkimi i Ujrave të Zeza
- 106 Ajrim
- 108 KUZ
- 110 KUB

SISTEMIMI I JASHTËM

- 114 Rrugë Këmbësore
- 116 Stola
- 118 Gjelbërim



KONSTRUKSIONI

SIGURIM TEKNIK


Sigurimi teknik përfshin tabelizimin brenda dhe jashtë objekteve. Këto tabela mundësojnë orientimin dhe sensibilizimin e qytetarëve për respektimin e rregullores gjatë lëvizjes në kantierin e ndërtimit.

Ato pozicionohen në të gjithë kantierin për të lajmeruar dhe parandaluar rrezikun nga proceset e ndryshme të ndërtimit. Materialet e përdorura për realizimin e tyre janë metalike të fiksuara në strukturën e objekteve apo në strukturat rrethuese të kantierit.



VINÇ


Kontakt disponon pesë vinça POTAIN GTMR 336A me vetë-mbledhje, të pozicionuar në zonën veriore dhe jugore të objektit të cilët ndihmojnë në realizimin e proçeseve të punës në kohë më të shkurtër dhe me efikasitet. Këta vinça janë 30.5 metra të lartë. Krahu i tyre është 40 metra i gjatë dhe mund të ngrejë pesha deri në 4000 kilogramë.



GËRMIM


Bazuar në studimin gjeologjik ku janë realizuar 5 shpime në thellësinë 15 m të cilat përfshijnë të gjithë themelet e Rezidencës "Marga" shtresat kryesore janë:

1. Toke vegjetale, suargjila të mesme me ngjyrë kafe me lagështirë, plastike të buta, përmbajnë rrënjë bimësh dhe lëndë organike, pak të ngjeshura.
2. Suargjila të mesme deri të lehta me ngjyrë bezhë në kafe dhe njolla gri. Janë me lagështirë plastike. Përmbajnë shtresa surere dhe pak guralecë, mesatarisht të ngjeshura.
3. Suargjila të mesme deri të rënda me ngjyrë bezhë në kafe, me pak lagështirë, plastike të forta, përmbajnë guralecë, të ngjeshura.
4. Argjila, alevrolite dhe ranore me ngjyrë gri më pak lagështirë me imentim të dobët, shumë të ngjeshura. Ujërat nëntokësore në dimër takohen në thellësi 4.2 m. Për fazën e gërmimeve themelet e objekteve janë të mbështetura kryesisht në shtresën: Skarpatat e treguara në vizatim janë me kënd 45° (1:1). Rekomandohet që për fazën e parë të gërmimit ato të përfundojnë në distancën 175 cm ose më shumë nga faqe e jashtme e themeleve të objekteve. Kuota e fazës së parë të gërmimit është kuota e nivelit të parë -15 cm



Pilota me kafshim është një nga metodat më të përdorura për të mbështetur objektet në terrene me formacione të dobëta. Me një ngurtësi shumë më të madhe sesa për shëmbull, pilotat e drurit, ato përdoren gjithashtu në rresht për t'u integruar në ndërtesën e ardhshme, si një mur në bodrum.

Duke qëndruar krah për krah, pilotat realizohen duke hedhur beton në zonat ku është shpuar me sondë. Afër ndërtesave ekzistuese, avantazh i kësaj metode është se nuk ka shumë zhurmë gjatë punimeve. Në rastin e pilotave me kafshim gjatë zbatimit ndodh që ujërat nëntokësore mund të depërtojnë përgjate faqes së pilotave. Këto rrjedhje mund të minimizohen me shtresa drenazhuese sikurse Delta Terrax. Faqja e gjeotekstililit të së cilës vendoset nga ana e pilotave për të ruajtur funksionin.




LEVOZHGË

Punimet e kallëperise horizontale dhe vertikale. Kallëperia për strukturat beton-arme është një strukturë e përkohëshme e cila duhet të plotësojë kërkesa sigurie dhe cilësie.

Ky proces kontrollohet gjatë gjithë kohëzgjatjes nga inxhinierët duke siguruar që punimet e karpenterisë të jenë konform standartit BS EN 8500.

Synimi i Kontakt për strukturën beton-arme të objektin Marga është realizimi i betoneve të pastra për të cilat bashkëpunon ngushtë me kompani lider në prodhimin e kalleperive si Paschal dhe Peri.



HEKUR



Projektimi i strukturave beton-arme në objektet që Kontakt realizon bazohen në Eurocode 2 (pr. EN 1992-1-1 Dec. 2003), Eurocode 3, Eurocode 8 dhe. KTP N2-89.

Hekuri i përdorur në objekt është i klasit B500 B me rezistencë në tërheqje $f_{yk} \geq 500 \text{ MPa}$ dhe me zgjatim në forcë maksimale 5% duke i plotësuar të gjitha karakteristikat e duktilitetit sipas standarteve europiane të projektimit dhe zbatimit.

Çdo porosi hekuri që vjen në kantierin tonë testohet sipas standarit ISO 6892-1 2016.

Testet për kontrollin e cilësisë që realizohen në laboratorin e Kontakt dhe laboratorë të jashtëm janë:


1. Përcaktimi i zgjatimit relativë.
2. Përbërja kimike.
3. Rezistenca në tërheqje.
4. Raporti këputje/rrjedhshmëri.



BETON


Proçesi i betonimit është ndër proçeset me vëmëndjen kryesore duke kontrolluar në vepër cilësinë, konsistencën, koha e përgatitjes së betonit për të siguruar që konsolidimi të jetë efektiv dhe i plotë. Betoni duhet të kompaktohet me vibratorë me rrotullim rreth 10 000 rpm.

Përbërja e betonit realizohet me çimento 42.5R dhe sipas standarteve europiane EN206-1, pra jo me më pak se 340kg/m³ dhe me raport ujë/çimento < 0.5. Në çdo betoniere të hedhur në vepër merren mostra të cilat testohen në laboratorë sipas standartit.



SKELA


Skelat Layher janë struktura të përkohshme për suportin e njerëzve dhe të materialeve, që ngrihen gjatë ndërtimit apo rikonstrukcioneve në objektet tona në fasada apo për punime të brëndshme. Me elementë të thjeshtë dhe projekt të detajuar punjonjësit tanë të kualifikuar në montime skelerie, sigurojnë struktura të sigurta për të punuar, konform të gjithë rregullave të sigurimit teknik.



NËNSHTRESË


Material me bazë rërë/çimento i cili aplikohet në ambientet mbitokë për mbulimin e instalimeve elektrike dhe hidraulike të vendosura në dysHEME.

Kjo shtresë respekton pjerresinë e përcaktuar nga projekti sipas ambienteve ku aplikohet. Përshtatet me çdo shtresë pasardhëse të saj si laminat apo pllaka të çdo lloji.




IZOLIM AKUSTIK HORIZONTAL

Membranë e cila vendoset në dysHEME ndërmjet penobetonit dhe nënshtresës siguron një amortizim dhe izolim të zhurmave dhe goditjeve që ndodhin në dysHEME.




MURATURË

Muratura 250 mm realizohet me tullë 100 mm, 50 mm lesh guri dhe tullë 100 mm.
Ky sistem murature me izolimin në mes ofron termoizolim dhe izolim akustik të apartamentit me hapsirat e përbashkëta dhe apartamentet e tjera. Muratura për ndarjet e brëndshme është 100 mm.
Për përforcim të muraturës do të ketë dhe kolonçina betoni me gjerësi sa vetë muri dhe gjatësi 250 mm.



SUVATIM

Suva mbushëse me çimento-gëlqere. Suva, për mure të brëndshme, tavanë dhe fasada me ngarkesë të ulët lagështie. Trashësia e aplikimit 15 mm. Fino është llaç i thatë i parapërzjerë i hollë për mure të brëndshme mbi suvatim mbushës. Trashësia e aplikimit 2-3 mm. Aplikohet me sprucim mbi sipërfaqen e suvatuar.






FASADË E VENTILUAR

Fasada e venteluar kontribon në rritjen e efektit izolues termik dhe akustik duke i dhënë objektit efikasitet të lartë, komfort dhe jetëgjatësi.


Shtresat e fasadës janë: Mur tulle 200 mm, Lesh Guri 80 mm, Ajer (për të krijuar ajrimin e fasadës) dhe Pllaka Qeramike.



DRITARE

Dritare alumini termik xham të dyfishtë dhe grila alumini me dimensione 1800x2400 mm dhe 900x2400 mm. Ngjyra e profilit të dritares në interior është e bardhë, ndërsa në exterior është e zezë.

Pos. W_Type 02_L, Quantity: 23
W_Type 02_L
Dritare 1 kanate 180M
Finish: RAL 9016/RAL 9005
Exterior View




2 W_Type 02_L
SCALE: 1:25




VETRATË DYQANE

Vetratë alumini me dimensione të ndryshme dhe me lartësi standart 3940 mm.
Vetrata përbehët nga një derë e hapshme dhe nga pjesa tjetër statike.
Ngjyra e profileve të aluminit të vetrates është e zezë.



① ELEVATION
SCALE: 1:20




② SECTION
SCALE: 1:20



GRILË



Një aksesori i rëndësishëm për dritaret e apartamentit janë dhe grilat. Grilat që Kontakt ofron janë të thjeshta me një dizajn minimalist të cilat ndihmojnë në ngrohjen e ambjentit dhe kursimin e energjisë deri në 30%.



PARAPET XHAMI

Parapet xhami me profile alumini me dimension i cili varion sipas lartësisë së çarjes në fasadë.
Është i inkastruar në kolonat strukturale vertikalisht.

Fiksimi i tillë i parapetit siguron qëndrueshmëri ndaj goditjeve mekanike dhe fushë vizive më të pastër.
Ngjyra e profilit të parapetit është e zezë.





 Mbani
Pastër


 3021-3026

HIDROIZOLIM NËNTOKË

Hidroizolimi nëntokë realizohet me dy membra DELTA®-Thene dhe DELTA®-TERRAXX. Kombinimi i tyre siguron mbrojtje dhe drenazhim DELTA®-Thene është një membranë bituminoze vetëngjitese e cila aplikohet për hidroizolime vertikale dhe horizontale.


DELTA®-TERRAXX ofron përdorim universal dhe siguri maksimale për muret nëntokë nga presioni hidrostatik i ujit, kullimi i ujit sipërfaqësor dhe ujit artesian.

Faqja e cila përballet me tokën formon një shtresë të kullimit mbi të gjithë sipërfaqen, duke tejkaluar kërkesat e DIN 4095. Shtresa e gjeotekstilit mban të pa bllokuar strukturën Dimple.




HIDROIZOLIM TUALETE

Pas rrafshimit dhe nivelimit të sipërfaqes realizohet hidroizolimi me Ardex. Ardex mund të aplikohet lehtësisht me një rrul bojërash ose një furçë për të prodhuar një shtresë shumë elastike. Kjo shtresë mbron nga infiltrimi i ujit në pjesën anësore dhe siguron një shtresë të shkëlqyeshme lidhëse për pllakat.



HIDROIZOLIM LLOZHA

Për parandalimin e ujërave të shiut realizohet hidroizolimi me Ardex në Llozha. Kjo shtresë mbron nga infiltrimi i ujit në ambientet e brëndshme dhe siguron një shtresë të shkëlqyeshme lidhëse për pllakat.






HIDROIZOLIM TARRCA 0.00

Hidroizolimi i tarracës 0.00 realizohet me dy membranë BAUDER dhe DELTA®-TERRAXX. Kombinimi i tyre siguron mbrojtje dhe drenazhim.

BAUDER është membranë bituminoze e cila ofron siguri dhe jetëgjatësi .


DELTA®-TERRAXX ofron përdorim universal dhe siguri maksimale për muret nëntokë nga presioni hidrostatik i ujit, kullimi i ujit sipërfaqësor dhe ujit artesian.

Faqja e cila përballet me tokën formon një shtresë të kullimit mbi të gjithë sipërfaqen, duke tejkaluar kërkesat e DIN 4095. Shtresa e gjeotekstilet mban të pa bllokuar strukturën Dimple.




HIDROIZOLIM TARRACA

Membranat hidroizoluese EVALON® nga Alwitra janë membra sintetike me cilësi të lartë për hidroizolime me një shtresë. Përqindja jashtëzakonisht e lartë e lëndëve polimerike i bën ato veçanërisht homogjene, të buta dhe elastike. Në të njëjtën kohë, ato janë veçanërisht të qëndrueshme dhe rezistente ndaj rreshjeve dhe rezistente ndaj depërtimit të rrënjëve.





BAXHË

Baxha PVC në tarracë është pjesë e sistemit antitym të shkallës. Siperfaqja e saj transparente dhe lehtësisht e hapshme realizon ndriçim natyral, ventilim dhe akses në tarracë. Ky sistem përshtatet me shtresat termo dhe hidro izoluese të tarracës për të realizuar mbylljen e hapësirës së shkallës në mënyrën më të mirë të mundshme si teknikisht ashtu edhe estetikisht.




HIDROIZOLIM GROPA ASHENSORIT

Hidroizolimi i Gropës së Ashensorit realizohet për të parandaluar infiltrimin e ujërave nëntokësore, duke garantuar jetëgjatësi në funksionimin dhe sigurinë e ashensorëve tanë. Sipërfaqja hidroizoluese me material Voltex përfshin 1m distancë nga gropa dhe me mbivendosje 15cm.




DAVANCAL DRITARE

Davancialet e aluminit GUTMANN ofrojnë mbrojtje të jashtëzakonshme nga faktorët atmosferike. Me një dizajn efektiv dhe të rrumbullakosur në skaje ky davancal krijon mbylljen e duhur të detajit të mëposhtem të dritares me fasadën e ventiluar.




DAVANCALE NË TARRACË

Davancali i aluminit është elementi i cili realizon bashkimin ndërmjet sistemit hidroizolues të tarracës dhe fasadës së venteluar. Materiali dhe forma e tij e përshtatshme mundëson fiksimin e sistemit përgjatë parapetit të betonit. Ky element i përshtatur posaçërisht për ti rezistuar ndryshimeve të kushteve klimatik, mundëson largimin e ujit duke mos e lejuar të kalojë në brendesi të strukturës së objektit.



ASHENSOR

Ashensori është një nga pjesët më të rëndësishme në një objekt banimi. Kjo teknologji e përdorur, mundëson eko-efikasitet, komoditet, pamje tërheqëse dhe fleksibilitet në lëvizje. Sistemi ofron përmirësim të komoditetit duhet arritur siguri dhe besueshmëri nga ana teknike nëpërmjet përsheptimit të ngadaltë dhe nivelim të saktë të kabinës në çdo kat të objektit. Ky sistem siguron reduktim të lëkundjeve dhe minimizim të zhurmave gjatë lëvizjes.




SHKALLË


Kafazi i shkallës është trajtuar si një zonë e veçantë e objektit. Muratura e suvatuar, kangellat prej metali dhe pllakat qeramike janë zëvendësuar me muraturë, shkallë dhe parapet të realizuara me beton të pastër, të trajtuara vetëm me primer për mirëmbajtjen e tyre. Ekspozimi në të tillë mënyrë i betonit të këtyre strukturave krijon mundësinë e trajtimit të tyre me një dizajn të veçantë dhe inovativ.



2 SECTION
SCALE: 1 : 50





1 PLAN
SCALE: 1 : 50




DYER TEKNIKE

Dyer alumini jo termik në ambiente teknike si depo uji dhe kabina elektrike. Me dy kanata të hapshme me dimension 800 mm, të veshura me grilë teknike dhe ngjyrë të bardhë. Dera do të vendoset mbi një prag betoni për arsye teknike, për shmangien e lagështisë së mundshme të këtyre ambienteve.




DERË E BLINDUAR

Dyer të blinduara të vendosura në hyrjen e shkallës. Profile metalike me sipërfaqe anti-gërvishëse, të mbushur me material termoizolues. Ky sistem siguron izolim termik dhe akustik. Ngjyra e dyerve do të jetë e bardhë në harmoni me interiorin e korridoreve dhe betonin e ekspozuar të shkallëve.




DERË E BRËNDSHME

Dyer druri të firmës gjermane LEBO të vendosura në ambientet e brendshme të njësive të banimit apo shërbimit. Panelet e drurit mbushen në brendësi me shirita tallashi me çarje cilindrike. Dimensionet variojnë sipas ambientit, ndërsa ngjyra e bardhë dhe pamja e thjeshtë e kthen derën në një mobilie të përshtatshme lehtësisht me interiorin e apartamentit, si dhe më të thjeshtë për t'u mirëmbajtur.




KUTI POSTE

Kutitë e postës janë të pozicionuara në korridorin hyrës të çdo objekti. Të vendosura në një lartësi të caktuar për t'u aksesuar nga çdo grupmoshë. Materiali metalik me sipërfaqe të trajtuar posaçërisht mundëson rezistencën ndaj korrozionit dhe jetëgjatësi në ambientet e përbashkëta të objektit. Ngjyra dhe dizajni i tyre është pjesë e interiorit të hyrjes në objekt.




SINJALISTIKË RRUGORE

Sinjalistika mbitokë që KONTAKT ofron është në standartet bashkëkohore. Në këtë mënyrë banorëve dhe vizitorëve nga jashtë kompleksit u bëhet shumë më i lehtë orientimi përsa i përket hyrjes dhe numrave të shkallëve në objekt falë tabelave orientuese në sistemimet e jashtme.




TABELIZIM

Tabelizimi përdoret për orientimin e banorëve brënda objektit. Gjithashtu funksionon për sensibilizimin e qytetarëve për rregullat bazë të ambienteve të perbashkëta siç janë mbani pastër ambientin, mos pini duhan etj. Në Mangalem²¹, përdorimi i tyre është shumë i veçantë pasi vijnë me ngjyra të ndryshme duke i'u përshtatur kështu konceptit të projektit. Materiali i përdorur është forex me trashësi 0,5 cm. Montimi i tyre realizohet me ngjitës biadeziv dhe ngjitës silikon.




PLLAKA

Pas aplikimit të nënshtresës mbi soletë për mbulimin e instalimeve elektrike dhe hidraulike realizohet shtrimi me pllaka qeramike me dimension 1200x600 mm. Ngjyra e pllakave kombinohet lehtësisht me interiorin e korridoreve ku do të aplikohen. Këto pllaka mirëmbahen lehtësisht duke siguruar jetëgjatësi më të madhe për hapësirat e përbashkëta që kanë një fluks të madh lëvizjeje.



LAMINAT


Pas aplikimit të nënshtresës mbi soletë për mbulimin e instalimeve elektrike dhe hidraulike, në apartamente realizohet shtrimi me parket laminat. Laminati i përdorur mund të mirëmbahet dhe të përshtatet lehtësisht me interiorin e ambientit ku do të aplikohet. Ngjyra e laminatit dhe batiskopit varion sipas preferencës së klientit. Kjo veshje për dyshemetë krijon ambiente të ngrohta dhe komode.



TRANSFORMATOR

Në Kabinën Elektrike të rezidencës Marga, janë montuar dy Transformatorë 20/0,4 kV dhe Çela SM6 24kV 630 A, të markës së njohur Schneider Electric. Këta transformatorë realizojnë furnizimin me energji elektrike të pesë shkallëve. Për mbrojtjen nga fushat elektromagnetike të transformatoreve është realizuar Kafazi i Faradeit i cili pengon përhapjen e tyre në ambientin përreth.


SKEMA E SHPERNDARJES SE ENERGJIJE NE KABINEN



MATËSA ELEKTRIK

Matësat elektrik janë të gjithë matësa elektronik. Ata mund të jenë matesa 3 fazor (zakonisht për bizneset) dhe matësa 1 fazor (zakonisht për abonentët familjarë). Matesat elektrik janë inkasuar në panele metalike. Panelet metalik janë gjithmonë të pozicionuara në katin përdhe dhe pranë shkallës.


DETAJ INSTALIME BOKES MATES ENERGJIE ELEKTRIKE




ÇELËSA DHE PRIZA

Instalimet elektrike në rezidencën Marga realizohen vetëm me materiale të Brandit ABB. Për instalimet e ndriçimit përdoren çelësa një polar, devijat, inverter dhe çelësa pulsantë, Për instalimet e fuqisë përdoren priza shuko dhe priza bivalente.

DETAJ INSTALIME ELEKTRIKE NE DHOME
MARTESORE




DETAJ INSTALIME ELEKTRIKE NE GUZHINE




NDRIÇUES BRENDË

Në katet -1 janë përdorur ndriçues linear 2x36 flouroshent ose ndriçues LED. Sasia e ndriçuesve është e tillë që të kapen normat e fluksit të ndriçimit, rreth 150 lux. Ndriçuesit në katet -1 mund të jenë të fiksuar në tavan me prozheniere ose mund të jenë të fiksuar në kanalinat metalike. Në të gjitha rastet ndriçuesit janë në podrume, janë të instaluar jashtë murit dhe janë linear.





NDRIÇUES JASHTË

Ndriçimi i jashtëm është projektuar për të gjitha rrugët e këmbësorëve dhe sheshin e brendshëm. Janë disa lloje ndriçuesish të jashtëm që janë përdorur ku ndër to mund të përmendim: ndriçues i varur, ndriçues shtyllor, ndriçues linear në rampë etj.



TELEFON / TV / INTERNET

Në të gjitha apartamentet nuk mungojnë sinjalet e internetit, telefonit dhe televizorit. Për sinjalin e internetit është përdorur kabell FTP Cat 5 dhe prizë RJ45. Për sinjalin telefonik është përdorur kabell UTP Cat 5 dhe prizë RJ-11 Cat 5. Për sinjalin televiziv tokësor dhe satelitor është përdorur kabell RG59.




RRUFE PRITËS

Të gjitha tarracat e pallateve mbrohen nga shkarkimet atmosferike.


Në të gjithë tarracat e ndërtesave janë shtruar shirita zinku me permasa 30x3 mm.

Tek të gjitha pajisjet metalike, komponentët më të gjatë se 1 m janë të lidhur me sistemin e mbrojtjes rrufeprites. Të gjitha objektet më të larta se sipërfaqja e kulmit janë të mbrojtura tërthore me shufra vertikale.




UJI FURNIZIM

Në impiantin e furnizimit me ujë të apartamenteve një rëndësi të veçantë ka skema se si furnizohen këto apartamente dhe materiali i përdorur për këtë impiant. Skema që është përdorur për këtë impiant është që linja e furnizimit nga rrjeti urban furnizon depot e ujit, me anë të pompave e dërgojmë ujin në linjën kryesore të furnizimit të grupit të kontatorëve dhe më pas me linja të veçanta furnizohet çdo apartament.





POMPË UJI

Pompa e furnizimit me ujë sanitar është pajisje kryesore në këtë impiant. Për këtë arsye është zgjedhur një grup pompash që komandohen nga një panel i vetëm. Grupi i pompimit e dërgon ujin në çdo konsumator me presionin e nevojshëm. Ky grup pompimi funksionon si një grup i vetëm dhe pompat hyjnë në punë sipas kërkesës së konsumatorit dhe në rast se njëra nga pompat del jashtë funksionit, kërkesat për fluksin e nevojshëm e mbajnë pompat e tjera deri në momentin që kjo pompë vihet përsëri në funksion.



MATËSA

Grupi i kontatorëve është “kolektori” që furnizohet me ujë nga stacioni i pompimit dhe më pas nga grupi i kontatorëve bëhet furnizimi me linja të veçanta për çdo konsumator. Nëpërmjet këtij grupi bëhet komandimi i presionit, mbyllja e ujit në rast defekti, pa shkaktuar ndërprerje tek apartamentet e tjera. Në rast të defekteve (rrjedhjeve) të këtij grupi nuk dëmtohet asgjë, siç ndodh me sistemin klasik që rrjedhja e ujit bëhet nëpër shkallet e pallateve. Kontrolli nga faturistët e UKT-së bëhet më i lehtë pa patur nevojë që ata të futen brënda ambienteve të banimit.



VALVUL NDERPRERSE Ø 3/4

FILTER "Y" Ø 3/4

VALVUL MOSKTHIMI Ø 3/4


MATES UJI Ø 3/4

VALVUL NDERPRERSE Ø 3/4



MKZ

Rrjeti i jashtëm i furnizimit me ujë të kompleksit është projektuar me rrjet unazor, që do të thotë se godinat furnizohen me dy rrjete. Ky rrjet është i qëndrueshëm ndaj humbjeve të presionit dhe në rast se njëra nga linjat pëson defekt godina furnizohet me ujë nga linja tjetër. Në këtë rrjet janë montuar edhe hidrantët e zjarrit nëntokësor, që në raste zjarri, autozjarrfikëset furnizohen me ujë në këto hidrantë pa patur nevojë të kthehen në bazë për t'u rimbushur.




SHKARKIMI I UJRAVE TË ZEZA

Shkarkimi i pajisjeve është ndërtuar duke përdorur tuba PP me gota me gominë dhe duke mbajtur diametra dhe pjerrësi sipas standardeve europiane. Tubat e shkarkimit pasi dalin nga pajisja shtrihen në shtresën e dyshemesë dhe lidhen me kolonën vertikale të shkarkimeve e cila është ndërtuar me kolonë balancimi për të bërë një funksionim sa më të mirë të këtij sistemi.




AJRIMI

Impianti i ventilimit të kuzhinave është një nga më të rëndësishmit e objekteve të banimit. Ky implant është delikat nga pikëpamja e problemeve që mund të shkaktojnë aromat e kuzhinave në ambientet e banimit dhe në apartamentet e të njëjtës godinë.




KUZ

Rrjeti i jashtëm i ujërave të zeza është ndërtuar për mbledhjen e ujërave të përdorur që vijnë nga kolonat e shkarkimit të ambienteve sanitare dhe për t'i shkarkuar ato në rrjetin urban të ujërave të zeza. Materialet që janë përdorur për këto tubat është polietilen i rrudhosur që plotëson të gjitha kërkesat e cilësisë të çertifikuar sipas standarteve europiane për ujërat e zeza.



KUB

Për kullimin e ujërave sipërfaqësor do të përdoret sistem linear i kullimit, termi linear përdoret për të theksuar natyrën sipërfaqësore të kullimit të kanaleve. Kanalinat e kullimit janë një pikë kyçe në menaxhimin e ujërave sipërfaqësor dhe duhet të menaxhohet me kujdes dhe në mënyrë të duhur.






SISTEMIMI I JASHTËM


RRUGË KËMBESORE

Rrugët këmbësore janë të projektuara në perimetër të objektit dhe në oborrin e brendshëm. Ato janë të shtruara me pllaka 48 mm, me dimensione të ndryshme të cilat krijojnë një teksturë të veçantë me ngjyrë gri.




STOLA

Stolat në sistemet e jashtme të Kontakt janë lehtësisht të identifikueshëm për finesen dhe dizajnin e tyre të personalizuar. Ato kanë në përbajtjen e tyre 2 materiale kryesore: metalin dhe drurin. Skeleti metalik i ndërthurur me materialin e drurit i sjell një pjesë të postmodernizimit KONTAKT-it.



GJELBËRIM

Në mënyrë që zonat e rekreacionit të jenë ftuese dhe të gjallëruara në çdo stinë të vitit është e nevojshme që këto nevoja të krijohen me anë të sistemimit të jashtëm për banorët e zonës. Për të pasur një zonë rekreative e cila të fton të shpenzosh më shumë kohë, një pikë mjaft e rëndësishme është gjelbërimi. Ajo që është marrë parasysh në krijimin e ambienteve të gjelbërimit nga Kontakt janë kombinimi që ju është bërë bimeve te ndryshme,



Të ndërtosh është shumë më shumë sesa duket...

